

VODAFONE ALBANIA sh.a.

**Pasqyrat Financiare sipas
Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Vodafone Albania sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Vodafone Albania sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Vodafone Albania Sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin e Drejtimit 2021 të Vodafone Albania Sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin e Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti i Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri


27 shkurt 2023
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjeli
Auditues Ligjor




PËRMBAJTJA

Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare.....	4
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	
2. Informacion i përgjithshëm	5
3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	5
3. Gjykime dhe vlerësime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël	19
4. Adoptimi i Standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet.....	22
5. Aktive afatgjata materiale	23
6. Aktive afatgjata jo-materiale.....	24
7. Inventarët	26
8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	26
9. Të ardhura të llogaritura dhe llogari të tjera të arkëtueshme	26
10. Aktive me të drejtë përdorimi	27
11. Llogari të arkëtueshme.....	28
12. Të Drejta Kontraktuale	28
13. Mjete monetare dhe ekuivalentët	28
14. Kapitali aksionar	29
15. Rezerva ligjore	29
16. Llogari të pagueshme	29
17. Llogari të tjera të pagueshme	29
18. Detyrime tatimore ndaj shtetit	29
19. Provigjone për taksa dhe çështje gjyqësore	30
20. Hua të palet e lidhura	30
21. Të ardhura të shtyra	31
22. Të ardhura nga kontratat me klientët	31
23. Të ardhura të tjera	31
24. Kosto e shitjes	32
25. Shpenzime shitjeje dhe shpërndarjeje	33
26. Shpenzime administrative	33
27. Shpenzime të tjera operative	33
28. Të ardhura të tjera operative	34
29. Shpenzime/Te ardhura financiare	34
30. Tatimi mbi fitimin	35
31. Transaksione me palë të lidhura	37
32. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	38
33. Shoqëria kontrolluese dhe shoqëria e fundit kontrolluese	38
34. Menaxhimi i rrezikut financiar	38
35. Ngjarje pas periudhës së raportimit	40

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	12,879,255,197	9,771,059,779
Aktive afatgjata jo-materiale	6	6,257,159,635	6,083,301,175
Investime ne Shoqeri	2	82,641,300	7,306,597,455
Emri i mire		1,622,550,682	-
Aktive tatimore të shtyra	30	859,451,718	763,658,529
Aktive të kontratës	12	43,940,392	44,529,207
Aktive me të drejtë përdorimi	10	2,154,175,477	1,397,206,265
Totali i aktiveve afatgjata		23,899,174,401	25,366,352,410
Aktive afatshkurtra			
Inventarët	7	132,817,524	179,124,984
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	495,021,445	233,593,042
Tatim fitimi i arkëtueshëm	30	1,005,018,690	1,039,326,015
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	289,941,660	405,667,383
Aktive të kontratës	12	131,302,638	85,158,420
Llogari të arkëtueshme	11	1,156,805,605	1,143,300,865
Mjete monetare dhe ekuivalente	13	1,833,003,559	2,215,240,827
Totali i aktiveve afatshkurtra		5,043,911,121	5,301,411,536
TOTALI I AKTIVEVE		28,943,085,522	30,667,763,946
Kapitali			
Kapitali aksionar	14	5,689,874,341	5,689,874,341
Rezerva ligjore	15	568,987,434	568,987,434
Pagesa në aksione	14	(40,006,384)	(27,838,609)
Fitimi i pashpërndarë (e mbajtura)		10,190,998,422	13,121,187,570
Totali i kapitalit		16,409,853,813	19,352,210,736
Detyrimet afatgjata			
Detyrime të qirasë	10	1,722,299,880	930,713,186
Provizgjone per detyrime	19	524,316,485	600,910,695
Hua nga Palet e lidhura	20	4,423,077,456	5,878,050,000
Detyrime te tjera afatgjata	17	228,936,086	229,344,751
Total current non-liabilities		6,898,629,907	7,639,018,632
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	16	1,721,929,455	1,534,668,825
Llogari të tjera të pagueshme	17	1,381,354,315	459,502,556
Detyrime të qirasë	10	341,515,870	296,745,929
Hua nga Palet e lidhura	20	1,011,126,740	616,200,000
Detyrime tatimore të ndryshme nga tatim fitimi	18	565,100,487	348,921,267
Të ardhura të papërfituara (detyrime nga kontrata)	21	613,574,935	420,496,002
Totali i detyrimeve afatshkurtra		5,634,601,802	3,676,534,579
Totali i detyrimeve		12,533,231,708	11,315,553,211
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		28,943,085,522	30,667,763,946

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim nga Drejtimi i Vodafone Albania sh.a. më 2023 dhe u nënshkruan nga:





Drejtor i Përgjithshëm

Artur Tomini

Drejtor i Departamentit të Financës

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga kontratat me klientët	22	16,103,699,498	13,641,947,527
Të ardhura të tjera	23	137,691,629	62,554,361
Kosto e shitjes	24	(14,009,996,999)	(10,185,980,530)
Fitimi bruto		2,231,394,128	3,518,521,358
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	25	(1,387,290,722)	(1,306,761,459)
Shpenzimet administrative	26	(1,617,692,208)	(1,391,508,829)
Shpenzime të tjera operative	27	(653,188,935)	(640,066,433)
Provizione për detyrime dhe pagesa	19	(31,204,767)	216,361,403
Të ardhura të tjera operative	28	29,716,849	60,390,724
Fitimi/(humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(1,428,265,655)	456,936,764
(Shpenzime)/të ardhura financiare neto	29	77,218,526	(145,657,843)
Fitimi/(humbja) para tatimit		(1,351,047,130)	311,278,921
Tatimi mbi fitimin	30	(13,078,617)	(212,552,829)
Fitimi/(humbja) neto për vitin		(1,337,968,513)	98,726,092
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		(1,337,968,513)	98,726,092

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Vodafone Albania sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë)*

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Pagesa në aksione	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	5,689,874,341	568,987,434	(30,543,586)	14,282,263,010	20,510,581,198
Fitimi i vitit	-	-	-	98,726,092	98,726,092
Dividentët e deklaruar dhe paguar gjatë vitit	-	-	-	(1,259,801,534)	(1,259,801,534)
Pagesat e bazuara në aksione	-	-	2,704,977	-	2,704,977
Gjendja më 31 dhjetor 2020	5,689,874,341	568,987,434	(27,838,609)	13,121,187,570	19,352,210,736
Fitimi i vitit (humbja e vitit)				(1,337,968,513)	(1,337,968,513)
Dividendët e deklaruar dhe paguar gjatë vitit				(623,643,398)	(623,643,398)
Rezerva e konsolidimit				(968,577,237)	(968,577,237)
Pagesat e bazuara në aksione			(12,167,775)		(12,167,775)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	5,689,874,341	568,987,434	(40,006,384)	10,190,998,422	16,409,853,811

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Vodafone Albania sh.a.**Pasqyra e flukseve monetare***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë)*

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
FLUKSET MONETARE NGA VEPRIMTARITË E SHFYTËZIMIT			
Fitimi neto para tatimit		(1,351,047,130)	311,278,922
Rregullime për:			
Zhvlerësime dhe amortizime	5,6,10	6,605,930,794	4,305,650,507
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata	5	3,568,879	4,234,861
Humbje nga nxjerrja jashte perdorimit e AAM		65,652,984	-
Provigjon për llogaritë e arkëtueshme	11	99,343,867	110,642,345
Kthim provigjoniper llogarite e arketueshme		(6,814,784)	-
Provigjon për zhvlerësimin e inventarit	7	37,915,975	46,043,378
Pagesat të bazuara në aksione	14	(12,167,775)	2,704,977
Provigjonet për çështje ligjore dhe të tjera	19	52,116,352	54,876,925
Kthim provigjioni për taksat dhe të tjera	19	-	(370,466,955)
Shpenzime nga interesi, neto	29	86,829,951	109,892,405
Humbje nga forex		-	367,614
Flukset monetare nga veprimtaritë e shrytëzimit përpara lëvizjeve në kapitalin punues		5,581,329,113	4,575,224,977
Ndryshimet në llogaritë e arkëtueshme dhe të drejta kontraktuale dhe parapagimet	8,10, 11, 12	8,391,485	(4,662,857)
Ndryshimet në inventarë	7	(392,342,010)	87,424,315
Ndryshimet në llogari të pagueshme dhe të tjera	15,16	1,560,809,883	(266,138,994)
Flukset monetare të gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit		6,758,188,472	4,391,847,441
Tatim fitimi i paguar	30	(266,212,008)	(296,663,753)
Interesi i arketuar	29	(86,829,951)	-
Paraja neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		6,405,146,513	4,095,183,688
FLUKSET MONETARE NGA VEPRIMTARITË E INVESTIMIT			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	5,6	(4,819,987,558)	(2,715,987,234)
Arkëtime nga shitja e AAM	5,6	1,291,522	-
Investime në Shoqëri të tjera		-	(7,306,597,455)
Paraja neto e përdorur në veprimtaritë e investimit		(4,818,696,036)	(10,022,584,689)
FLUKSET MONETARE NGA VEMPIMTARITË E FINANCIMIT			
Pagesa dividendi	10	(279,370,151)	(490,708,579)
Pagesa për principalin e detyrimeve të qirasë	14	(623,643,398)	(1,259,801,532)
Hua të marra	20	-	6,494,250,000
Hua te paguara		(1,060,050,000)	-
Paraja neto e përdorur në veprimtaritë e financimit		(1,963,063,549)	4,743,739,889
Shtim/(pakësim) neto i mjeteve monetare dhe ekuivalente (Neto (ulje) në para dhe ekuivalentet e parasë)		(376,613,074)	(1,184,028,724)
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	13	2,209,616,631	3,393,645,355
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit		1,833,003,559	2,209,616,631

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.